

E DREJTA ISLAME

Ka mendime sipas të cilave qytetërimi tradicional islam përshfaqet si diçka që mund ta krahasojmë me një dru frutor, i cili është mbjellë, ka mbirë dhe ka hedhur shtat në një hapësirë ekzotike. Por e vërteta është se, përtej të qenit një hierarki aksiologjike e ndryshme nga qytetërimet e tjera, përfshi atë të krishterë, islami duhet këqyruar si rrjedhoja e natyrshme e evolucionit mendor e shpirtëror e disa popujve, të cilët ndryshe nga ata që banojnë në Europë, kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një mënyrë jetese të vetën, në pajtim me mjedisin, ndonjëherë jo fort pjellor, dhe realitetet historike u kanë diktuar ngjizjen e një bote shpirtërore të mirëdallueshme.

Mendimi juridik, duke qenë vetëm një nga përbërësit e çdo qytetërimi, mund të zberthohet në kontekstin e dukurisë që e jetëson. Aq më tepër kur bëhet fjalë për islamin, për të cilin Raymond Charles është shprehur:

“Islami (nga: selam – “nënshtrim ndaj Allahut”) është para së gjithash fe, pastaj shtet e, më në fund, kulturë”.

Duke mos qenë konservator e ca më pak fanatik, islami, edhe në sistemin juridik të së drejtës, ka ndjekur hap pas hapi zhvillimet e sotme, duke mos mohuar apo shpërfillur aspak sistemin juridik evropian.

Gadishulli Arabik, hapësira në të cilën u shfaq islami, përmes themelvënësit të tij, Profetit Muhamed, nuk kishte pasur ndonjë organizim fetar, politik dhe social të mirëfilltë. Vetëm disa fise ishin krishterizuar, ndërsa arabët e Gadishullit Arabik me të njëjtin emër praktikonin politeizmin primitiv.

Bashkë me përkrahësit e tij, Profeti Muhamed shkoi në Medinë, ku bëri për vete fiset e beduinëve e më pas krerët e Mekës. Hap pas hapi feja e re u përfaqua nga krejt bota arabe. Ajo, siç dihet, shpalli një qëllim jetik: nënshtrimin (bindjen) ndaj Allahut dhe zbatimin e porosive të tij. Veprimtaria e kësaj feje zhvillohet përmes institucionesh, të cilat njëherazi janë edhe norma juridike dhe mbështeten në radhë të parë në pesë *“shtyllat e besimit”*:

- Salati (Namazi) – Lutjet pesë herë në ditë;
- Zekati – ndarja për nevojtarët e 2.5 % nga pasuria e ligjruar;
- Sauni – Agjërimi në muajin e Ramazanit;

- Haxhi – pelegrinazhi në Mekë;
- Shehadeti – dëshmia e besimit, që konsiston në përsëritjen e formulës: La Ilahë il-laLlah, Muhamedun resuluLlah, “*Nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe Muhameti është i dërguari i Tij*”.

Islami zgjodhi rrugën e mesme për pasuesit e tij.

“O bij të Ademit! Mund të vendosni zbukurime në të gjitha vendet e lutjes. Hani e pini, por mos e teproni” (Kurani 7:31).

Pranohen dallimet sociale, por në umma (bashkësia e besimtarëve) të gjithë janë të barabartë.

Krejt historia e njerëzimit, sipas islamit, do të marrë fund me ditën e Kiametit (dita e fundit kur mer fund kjo botë), për të vazhduar më pas me “*Ringjalljen*” dhe “*Gjykimin e Mbramë*” në botën e përtejme, kur çdo besimtar do të japë llogari për veprimet e tij. Fundi i kohërave të kësaj bote do të shenjohet nga një turbullirë e papërfytyrueshme, pas së cilës do të shfaqet Mehdiu (“*Udhërrëfyesi*” apo “*I udhëzuar i Allahut*”).

Feja islame ka dy aspekte, teologjinë që përcakton normat fetare duke saktësuar besimin e çdo myslimani dhe sheriatin – aspektin legjislativ, “*Rrugën që duhet ndjekur*” – tërësi rregullash sjelljeje, të cilat çdo besimtar duhet t’i mbajë mirë parasysh.

Jeta fetare islame veçorizohet nga fakti që njeh vetëm një detyrim juridik, i cili ka si objekt të saktësuar qartë “*respektimin e e detyrave që ka përcaktuar Allahu*” dhe “*të drejtave të njeriut*”. Kundrejt këtij koncepti, veprimet e njerëzve ndahen në pesë kategori: “*të detyrueshme*”, “*të këshillueshme*”, “*të pakëshillueshme*”, “*të detyrueshme*”, dhe “*që meritojnë të ndëshkohen*”.

Mësimet e Muhamedit pas vdekjes së tij janë interpretuar në mënyra të ndryshme duke lënë shteg për mosmarrëveshje ndërmjet sunizmit, i cili përfaqëson islamin e shumicës dhe ka në themel Kurandin e Sunnetin (“*praktikën tradicionale*”) dhe shiizmit, i cili njeh Aliun si kalif të parë “*të vërtetë*”. Si pasojë e kësaj, qysh në fillimet e veta, islami pati një numër të madh sektesh e shkollash, jo rrallë herë antagonistë.

Sipas sunitëve, ligji dhe teologjia janë solidarë, çka i jep ligjit mysliman një fushë shumë më domethënëse se sa sistemeve juridike perëndimore. Burimet ushqyese të ligjit mysliman janë Kurani, Sunneti, ixhmai apo mirëkuptimi i njëzëshëm i komunitetit, ixhtihadi apo përsiatja vetjake ose në grup.

Kurani, libri i shenjtë i myslimanëve, është shkruar pas vdekjes së Profetit Muhamed, nga Zeidi, njëri nga ashabët (shokët) e tij me urdhër të kalifit Osman dhe pasqyron besnikërisht fjalët e përcjella nga Allahu me anën e Profetit Muhamed për njerëzimin. Teksti i Kuranit është i përbërë nga 114 sure (kapituj), që kanë numër të ndryshëm versetesh (fjalish).

Për ata specialistë europianë që shohin ndonjë mospërputhje, përgjigjja gjendet në faktin që ka pasur dy orientime të veçanta për studimin e mësimëve të Muhamedit. I pari zgjat deri në Hixhra (*emigrimi në Medine*), kur mësimet e mësipërme i janë drejtuar me përparësi popullsisë urbane që merrej sidomos me tregti, ndërsa i dyti pasqyron mënyrën e jetesës së beduinëve, mes të cilëve Profeti jetoi "*pas emigrimit*".

Kurani është një vepër teologo-juridike që, doradorës me zgjerimin e shoqërisë myslimane, u pasurua me Sunna (sjellje, mënyrë e veprimit të Muhamedit a.s.) dhe me përmbledhjet me hadithe (thënie) të Profetit e të idhtarëve të tij, që përbëjnë "*praktikën tradicionale*".

Çdo hadith përmban dy elemente: tekstin dhe shpjegimin e tij, që shpreh vargun e transmetuesve të njëpasnjëshme nga koha e Profetit deri në shekullin IX, kur u hartuan përmbledhjet e haditheve.

Burimi i tretë, ixhma, mirëkuptimi i njëzëshëm i bashkësisë së besimtarëve, është një marrëveshje për njëjtësinë e interpretimit të teksteve të shenjta. Ixhma ka në themel hadithin:

"Bashkësia jonë nuk do të bjerë kurrë dakord me ndonjë gabim".

Në Kuran thuhet:

"Ai që ndjek rrugë tjetër përveç asaj të besimtarëve të mirëfilltë, do të shkojë në ferr".

Më në fund, ixhtihadi, fryma krijuese në lëmin e së drejtës, doli si kërkesë e shndërrimeve të shoqërisë myslimane dhe i shtyu dijetarët të përdornin logjikën e tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Metoda që përdor ixhtihadi quhet "*kijas*" (arsyetim analogjik). Sipas doktrinës tradicionale, kijasi përmban katër elemente:

- Rrënja – përshkrimi që ekziston në Kuran ose në Sunna, nga ku zë fill arsyetimi;
- Dega-aspekti konfliktual;
- Shkaku – i qartë, i kuptueshëm, i pakundërshtueshëm nga Kurani, Sunna apo ixhmaja, i cili duhet të vërtetohet;
- Gjykimi.

Në kohën tonë, Kurani dhe Sunna përfaqësojnë themelet historike të burimeve juridike e teologjike islame, ixhtihadi u shkëput në shekullin IV pas hixhretit, e cila është data kur Profeti Muhamet shkoi nga Meka në Medinë, pra më 16 korrik 622. Hixhreti përfaqëson edhe datën e fillimit të kalendarit islam. E vetmja bazë e pandryshueshme e së drejtës myslimane mbeti ixhmai.

Krahas burimeve të lartpërmendura, në formimin e sistemit juridik islam rol të rëndësishëm ka luajtur edhe zakoni (Urf). Përsa i përket aktit legjislativ, u pranua që ky mund të kompletojë ato fusha që nuk ishin shteruar nga e drejta e shenjtë.

Aktualisht, në parim, shtetet islamike kanë adoptuar kode sipas modelit evropian, që përfaqësojnë shartesa të parimeve të së drejtës myslimane me shkencën juridike evropiane. Kështu, për shembull, Kodi Civil egjiptian përcakton:

“Në mungesë të një dispozite ligjore të zbatueshme, gjyqtari do të veprojë në përputhje me zakonin (Urf), ndërsa në mungesë të këtij të fundit, do të verë në zbatim parimet e së drejtës myslimane. Në mungesë të këtyre parimeve, gjyqtari mund ta japë vendimin sipas së drejtës së natyrshme dhe barazisë”.

E drejta kanonike (fikh) njih disa sisteme apo rite juridike, që diferencohen nga hollësi të thjeshta gjatë zbatimit praktik dhe që propozohen nga shkolla të ndryshme juridike. Në universitetet e mëdha fetare mësohen idetë e katër shkollave tradicionale të mbarëpranuara: malikite (mbizotëruese në Afrikën e Veriut dhe në Afrikën Perëndimore), hanafite (në Turqi, në Indi dhe në Kinë), shafiite (në Afrikën Lindore dhe Jugore e në Palestinë), hanbelite (në Gadishullin e Arabisë).

Përsa i përket shkeljes së një norme sjelljeje, pra rënies në mëkat, ndëshkimi do të zbatohet nga “Gjykimi i Mbramë”, ku, ndoshta, nuk do të ekzistojnë rrethana lehtësuese apo motive për shmangien e natyrës penale të aktit, dhe as imunitet për ndonjë nga “Të Zgjedhurit”.

Ndryshe nga e drejta evropiane, juristi mysliman ka vizionin e vet që përfshin zgjidhje konkrete, për secilin rast më vete, duke mënjanuar përgjithësimet ose përkufizimet.

Huadhënia me përqindje fitimi për personat fizikë është e ndaluar. Por bankat, arkat e kursimit dhe shoqëri të tjera të kësaj natyre, duke qenë persona juridikë, nuk i nënshtrohen kësaj pengese.

Për ta kuptuar sa më mirë të drejtën islame duhen analizuar disa nga institucionet themelore të saj.

Në Të Drejtën Civile, jo individi, por familja përbën subjektin thelbësor të së drejtës. Kur kryetari i familjes ndërron jetë, zë fill një familje e re, pa asnjë lidhje vazhdimësie me të vjetrën. Martesa është një kontratë e thjeshtë, e çliruar prej çdo elementi të shenjtë apo mistik. Kjo bëhet me marrëveshjen e prindërve të bashkëshortëve të ardhshëm, ndërsa objektin e martesës e përbëjnë, nga njëra anë nusja, ndërsa nga ana tjetër një shumë të hollash. Poligamia lejohet deri në 4 gra, por bashkëshorti duhet t'i trajtojë njëllor bashkëshortet dhe t'u sigurojë mjete jetese dhe banesa më vete. Bashkëshortet duhet t'i binden dhe t'i qëndrojnë besnike, pa pasur të drejtë të dalin nga shtëpia pa lejen e tij.

Ndër arsytet e prishjes së martesës numërohen apostazia (kalimi në një fe tjetër), tradhtia bashkëshortore, përbuzja dhe urrejtja, divorci me mirëkuptim të dyanshëm.

Përsa i përket të drejtës së trashëgimisë, ka tri kategori trashëgim-tarësh dhe rregullat e ndarjes së pasurisë, që burojnë nga Kurani dhe nga disa hadithe, janë tepër specifike.

Rekomandimi për të krijuar të mira materiale të patjetërsueshme të destinuara për Allahun, shkojnë në objekte të shenjta të kultit islam, në vepra bamirësie ose për interes publik. Rekomandimi i mësipërm i dha shkas krijimit të një institucioni të posaçëm, vakëfit, që u përhap gjerësisht duke u mishëruar në terrene me sipërfaqe të mëdha, ndërtime të panumërta, plantacione, biblioteka etj.

Lidhur me aspektin penal në Të Drejtën Islame, krimet ndahen në tri kategori:

- Vrasja e njeriut ose plagosja e tij me dashje, që jep të drejtën e dënimit kapital ose kompensimin me të holla;
- Plagosja pa dashje, që zgjidhet me pagimin e një dëmshpërblimi në të holla;
- Krimet që përbëjnë objektin e pesë ndëshkimeve kanonike: vjedhja, e ndëshkuar me prerjen e dorës së djathtë; plaçkitja, e dënuar me vdekje; tradhtia bashkëshortore, e ndëshkuar me njëqind fshikullime, njëllor për burrat e për gratë; fajësimi i rremë për tradhti bashkëshortore, apostazia dhe konsumimi i pijeve alkoolike.

Fajet më pak të rënda dënohen vetëm me një qortim të rreptë. Ligji zbatohet nga kadiu, i cili është njëherazi gjyqtar dhe noter. Ai i jep vendimet për të gjitha çështjet ligjore. Ai mund t'ua kalojë disa kompetenca disa kadilerëve e gjyqtarëve me gradë më të ulët. Kadiu i gjykon të pandehurit

sipas rritit të cilit i përkasin. Në qytetet e mëdha ka një kadi për secilin rit, sepse shiitët, jo gjithmonë pranojnë të gjykohen sipas rregullave sunite. Shiitët njohin imamin si të vetmin autoritet ligjor kompetent. Për disa shkelje të vogla, që nuk parashikohen në legjislacionin penal islam, gjykimi i është lënë në dorë prefektit të policisë.

Bibliografia

- [Christian Schuster](#), B Islam, [Gerter Haar](#), JJ Busuttil – jsri.ro
- [Nathalie Clayer](#), *Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe* (Paris: Éditions Karthala. Collection H des Suds – ceeol.com
- [Studii și articole](#), [E JURCAN](#) – ceeol.com
- “Studime dhe provokime fetare në Evropën bashkëkohore”. Emil JURCAN ... 2 “Pluralizmi fetar autentik nënkupton një multikulturalizëm të vetvetishëm”; Terence Lovat, Religious pluralism can be seen to resemble multiculturalism, Reconciling Islam, Christianity and Judaism
- STUDIME–ARTIKUJ–DISKUTIME–KOMENTE–ANALIZA, PALESA AL, I DE TERORISM – ceeol.com
- Kult, magji, herezi: artikuj nga enciklopeditë e feve, IP Culianu – 2016 – books.google.com
- [Faith and practice are different matters in Islam](#), S Preda – Journal for the Study of Religions and Ideologies, 2015 – ceeol.com
- KISHA TRADICIONALE, REFORMA DHE ISLAMI NË BANAT, [A Magina](#) – researchgate.net
- [PDF] [mtak.hu](#)
- ISLAMI DHE PAKICAT FETARE NË KUSHTETUTËN E RE SIRIANE TË VITIT 1950. [Gerrie ter Haar](#), [James J. Busuttil](#) (eds.) [Bridge or barrier: religion, violence and visions for peace](#) [C Schuster](#) – Journal for the Study of Religions and Ideologies, 2010 – jsri.ro